



**Komisioni i  
Pavarur i  
Kualifikimit**

## **NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR**

### **SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ZNJ. ANIDA BICA**



12/07/2024

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 8.7.2024, për subjektin e rivlerësimit, znj. Anida Bica bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

Konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anida Bica, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

Vendimi, i arsytuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Pamela Qirko, znj. Valbona Sanxhaktari relatore, znj. Alma Faskaj anëtare do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 12.7.2024.

\*Informacioni është aksesuar në faqen e KPK në datë 15.07.2024 në linkun <https://kpk.al/njoftim-mbi-seancen-e-shpalljes-se-vendimit-per-subjektin-e-rivleresimit-znj-anida-bica/45/>